



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 09 /2024
Datë: 25.09.2024

Njësia për Burime Njerëzore në Akademinë e Drejtësisë, në pajtim me dispozitat e nenit 38 paragrafit 1, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke u bazuar në dispozitat e nenit 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për procedurën e pranimit në shërbimin civil, në vijim të procedurës së verifikimit paraprak të aplikacioneve për konkursin me nr. reference RN00014802 dhe konkursin me nr. reference RN00014836, nxjerr këtë:

VENDIM
për vazhdimin e afatit

1. Për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative, shtyhet afati edhe për 15 ditë të tjera për përfundimin e procedurës së verifikimit të aplikacioneve për konkursin me numër reference RN00014802 për pozitën "Zyrtar certifikues" dhe konkursin me numër reference RN00014836 për pozitën "Udhëheqës i divizionit për shërbime ligjore dhe bashkëpunim ndërinstytucional" në Akademinë e Drejtësisë.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
3. Vendimi publikohet në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Arsyetim

Duke marr parasysh numrin e madh të aplikacioneve të pranura për konkurset me numër reference RN00014802 dhe konkursin me nr. reference RN00014836 si dhe konkurset në zhvillim në të njëjtën kohë, për shkak të vëllimit të madh të aplikacioneve, në pamundësi të përfundimit të procesit të verifikimit brenda afatit fillestar, në pajtim me dispozitat e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Njësia për Burime Njerëzore

Akademia e Drejtësisë

